

Çfarë ndodh me konsumatorin i cili nuk respekton marrëveshjen për pagesën e borxhit me këste?

Personat të cilët lidhin marrëveshje me Telekom i Kosovës Sh.A. (ish PTK), për pagesën e borxheve me këste për periudhën 01 Janar 2009 deri me 31 Dhjetor 2014 dhe nuk respektojnë kushtet e marrëveshjes, Telekom i Kosovës Sh.A. (ish PTK), të njëjtit do t'i vendos në listën e borxheve, duke i bërë obligues për të gjitha borxhet e mbetura sipas kërkesave ligjore që kanë qenë të zbatueshme para lidhjes së marrëveshjes.

Kush mund të lirohet nga procedurat?

Konsumatorët të cilët kanë borxhe të pashlyera deri me 31 Dhjetor 2008 dhe shuma totale e borxhit bazë është në vlera të vogla prej 1€ deri në 100€, nuk kërkohet t'ju nënshtrohen procedurave të parapara për faljen e borxhit, ato do të fshihen në mënyrë automatike nga Telekom i Kosovës Sh.A. (ish PTK).

E drejta për të realizuar përfitimin nga falja e borxhit?

Vetëm konsumatorët të cilët shfrytëzojnë këtë mundësi dhe përmbushin detyrimin e kërkuar brenda periudhës prej një (1) viti nga dita e hyrjes në fuqi të Ligjit për Faljen e Borxheve Publike, do të përfitojnë nga falja e borxhit.

Kontakti:

Secili konsumatorë duhet të drejtohet në zyrën përkatëse Regjionale të Telekom i Kosovës Sh.A. (ish PTK), me qëllim që të përmbushë procedurat e parapara nga Telekom i Kosovës Sh.A. (ish PTK) dhe të përfitoj nga falja e borxhit.

Qyteti	Adresa	Nr.Kontaktit
Prishtinë	Pr. Dardania, Rr. Dardania, p.n Ndërtesa kryesore	038 554488, 038 544181 038 544021, 038 543303
	Pr. Qafa, rr. UCK	038 555112
	Pr. Qendra e Biznesit Bulevardi Nëna Tereze	038 220012
Prizren	Prizren, Rr. Pushka Tares nr 357	029 225044
		029 242151
Gjakovë	Gjakovë, Rr. e UÇK-së	0390 330105
		0390 329979
Pejë	Pejë, Rr. Mbretresha Teutë	039 432090
		039 432300
Mitrovicë	Mitrovicë, Rr. Arta	028 538988
		028 538100
Ferizaj	Ferizaj, Rr. Dëshmorët Kombit	0290 329666
		0290 329100
Gjilan	Gjilan, Rr. Adem Jashari	0280 324858
		0280 325200

Për më shumë informata lidhur me Faljen e Borxheve, Kontakttoni **Qendrën e Thirrjeve** Telekom i Kosovës Sh.A. (ish PTK)

Tel. 0800 10000



**Përfito nga shlyerja e borxhit ndaj
Telekomi i Kosovës Sh.A. (ish. PTK)**

Përfito nga Ligji për Faljen e Borxheve Publike

Ligji Nr. 05/L-043 për Faljen e Borxheve Publike, u mundëson konsumatorëve të përfitojnë në shlyerjen e borxheve të vjetra dhe detyrimeve tjera ndaj Telekomit i Kosovës Sh.A. (ish PTK), për shërbimet e **Telefonisë Fikse** dhe **Telefonisë Mobile**.

Kush mund të përfitoj faljen e borxhit ndaj Telekomit i Kosovës Sh.A. (ish PTK)

Të gjithë personat fizikë dhe juridikë të cilët kanë borxhe ndaj Telekomit i Kosovës Sh.A. (ish PTK), deri më 31 Dhjetor 2008, mund të përfitojnë nga falja e borxhit, nëse plotësojnë kriteret dhe iu nënshtrohen procedurave të parapara nga Telekomit i Kosovës Sh.A. (ish PTK), për faljen e këtyre borxheve.

Cilat janë kriteret që duhet plotësuar nga konsumatori për të përfituar nga falja e borxhit?

Për të përfituar nga falja e borxheve ndaj Telekomit i Kosovës Sh.A. (ish PTK), duhet:

- Të kryej pagesën e plotë të borxhit bazë (kryegjësë) për periudhën nga 01 Janar 2009 deri me 31 Dhjetor 2014, ose
- Të lidh marrëveshje me Telekomin e Kosovës Sh.A. (ish PTK), për pagesën e borxheve me këste, për periudhën 01 Janar 2009 deri me 31 Dhjetor 2014.

Nga falja e borxheve publike për periudhën deri **31 Dhjetor 2008**, përfitojnë të gjithë personat të cilët kanë obligime të pashlyera ndaj Telekomit i Kosovës Sh.A. (ish PTK), me kusht që të njëjtit të kryejnë pagesën e plotë të borxhit bazë (kryegjësë) për periudhën nga **01 Janar 2009** deri me **31 Dhjetor 2014**. nga falja e borxheve publike, duke përjashtuar interesin dhe gjobat, përfitojnë të gjithë konsumatorët, të cilët lidhin marrëveshje me Telekomin e Kosovës Sh.A. (ish PTK), për pagesë me këste dhe respektojnë marrëveshjen e lidhur.

A mund të përfitohen lirime edhe për periudhën pas vitit 2008?

Personat të cilët plotësojnë kriteret e lartpërmendura, përveç faljes së tërësishme të borxhit për periudhën deri me 31 Dhjetor 2008, do të përfitojnë edhe me faljen e gjobave, ndëshkimeve, interesit dhe çdo obligim tjetër që rrjedh nga mos pagesa me kohë e borxhit bazë për periudhën 01 Janar 2009 deri me 31 Dhjetor 2014.

Po ashtu, edhe konsumatorët të cilët nuk kanë borxhe para 31 Dhjetor 2008, por kanë borxhe nga **1 Janari 2009** deri më **31 Dhjetor 2014**, nëse kryejnë pagesën e plotë të borxhit bazë (kryegjësë) për periudhën nga **01 Janar 2009 deri me 31 Dhjetor 2014**, do të përfitojnë nga falja e ndëshkimeve, interesit dhe gjobave, deri më **31 Dhjetor 2014**.

Për më shumë informata kliko:

LIGJI NR. 05/L-043 PËR FALJEN E BORXHEVE PUBLIKE



Udhëzimi Administrativ (QRK) - Nr. 04/2015 për procedurat e faljes së borxheve publike

Shkarko si PDF